

**Universiteti Politeknik i Tiranës, Fakulteti i Inxhinierisë Matematike dhe Inxhinierisë Fizike, shpall vendet e lira si më poshtë:**

**I. Departamenti i Inxhinierisë Matematike shpall 3 (tre) vende pune për personel akademik me kohë të plotë, 2 (dy) të kategorisë “Lektor” dhe 1 (një) të kategorisë “Asistent-lektor”, kandidatët duhet të plotësojë këto kritere:**

1. Të kenë fituar diplomë të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në sistemin 3+2 në Inxhinieri Matematike pranë FIMIF, UPT; ose degë ekuivalente me to në ndonjë universitet të huaj jashtë vendit (Diplomë që është ekuivalentuar nga MASR).

2. Të kenë fituar diplomë të ciklit të dytë “Master i Shkencave” në sistemin 3+2 në Matematikë ose Inxhinieri Matematike dhe Informatike në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT, ose degë ekuivalente me to në ndonjë universitet të huaj jashtë vendit (Diplomë që është ekuivalentuar nga MASR).

3. Diplomë të matematikës speciale 5-vjeçare (program i vjetër studimi) ose diplomë ekuivalente me të në Fakultetin e Shkencave të Natyrës, UT.

4. Të kenë përfunduar studimet me notë mesatare:

- i. Mbi 8.5 (në të dy ciklet e studimit Bachelor dhe Master i Shkencave), për studentët që kanë përfunduar studimet në Shqipëri, ose të ekuivalentuar mbi 8.5, për studentët që kanë përfunduar studimet jashtë Shqipërisë;

5. Kandidatët duhet të jenë të aftë të punojnë në grup. Nuk pranohet kandidati i përjashtuar nga puna për shkelje disiplinore dhe morale.

Departamenti propozon këto kritere për vlerësimin e kandidatëve, të renditura sipas rëndësisë së kriterit:

1. Titulli “Profesor” – “Profesor i Asociuar” - grada “Doktor”.
2. Ekselencia dhe rezultatet e kandidatit në programet e studimit.
3. Pozicioni në listën e renditjes së universiteteve e shkollës përkatëse jashtë vendit ku ka kryer studimet kandidati.
4. Artikujt shkencorë të botuar si dhe pjesëmarrjet me referime në konferenca shkencore.
5. Experiencë pune në mësimdhënie, preferohet stazh pune në universitete ose në shkolla të larta, experiencë në procesin e kualifikimit shkencor, experiencë në hartimin dhe realizimin e projekteve të ndryshme.
6. Kultura e komunikimit e vlerësuar nëpërmjet intervistës së kandidatit.

7. Zotërimi i një gjuhe të huaj me dëshmi (anglisht, frëngjisht, gjermanisht) dhe kualiteti i dëshmisë i vlerësuar sipas standardit të Qendrës së Gjuhëve të Huaja UPT. Anglishtja ka përparësi.
8. Zotërimi i një gjuhe të dytë (italisht, spanjisht, rusisht etj.) me dëshminë përkatëse si më lart.
9. Njohja dhe përdorimi i kompjuterit dhe programeve bazë si Word, Excel etj. Njohja e programeve matematikore si Matlab, Maple, Mathcad, Matematika, Statistika, SPSS etj.
10. Pjesëmarrja në borde editoriale, referenca në revista dhe buletine, anëtarësime në borde të ndryshme konferencash apo dhe aktiviteteve të tjera me karakter akademik dhe mësimor, projekte etj.
11. Botime, artikuj të botuara në revista prestigjioze dhe me indeks të lartë.

## II. DOKUMENTACIONI DHE AFATI I DORËZIMIT

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentet si më poshtë:

1. Kërkesë me shkrim për aplikim;
2. Jetëshkrimin (CV) sipas formatit standard;
3. Fotokopje të pasaportës ose kartës së identitetit;
4. Diplomën e studimeve universitare dhe listën e notave të noterizuar; (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
5. Kopje e Diplomës Master i Nivelit të Dytë ose "DOKTOR" të noterizuar, në rast se ka. (Aplikantët që kanë kryer studime jashtë shtetit duhet të kenë bërë njohjen e diplomave nga MASR);
6. Fotokopje të librezës së punës të noterizuar;
7. Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore;
8. Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
9. Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimin shtesë, vlerësimet pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin e paraqitur;
10. Dëshminë e gjuhës së huaj të noterizuar.

Të gjithë kandidatët duhet të paraqesin brenda datës **08.11.2019** pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore në Rektoratit e Universitetit Politeknik të Tiranës dokumentacionin e sipërcituar.

